
RREGULLORE NR. 2001/38

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË NDRYSHUAR TË UNMIK-ut NR. 2000/2
MB AKCIZAT NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Kosovën të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik 1999 mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe nenin 8.1(ç) të Rregullores së UNMIK-ut 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese të Qeverisjes së Përkohshme në Kosovë,

Pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/2 të datës 22 janar 2000, të ndryshuar, mbi Akcizat në Kosovë,

Me qëllim të lehtësimit të zbatimit të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/2, të ndryshuar, për përfundimin e konvertimit nga marka gjermane ("DM") në euro,

Me anë të kësaj Rregulloreje shpall sa vijon:

Neni 1

Ndryshimet e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/2, të ndryshuar, mbi Akcizat në Kosovë

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/2 mbi Akcizat në Kosovë, e ndryshuar, dhe Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/15 e datës 3 korrik 2001 do të ndryshohet si vijon:

Në shtojcën A, kudo që të paraqitet:

- (a) "0.3 DM" do të zëvendësohet me "0.15 euro";
- (b) "0.4 DM" do të zëvendësohet me "0.20 euro";
- (c) "2 DM" do të zëvendësohet me "1 euro";
- (d) "4 DM" do të zëvendësohet me "2 euro";

- (e) “1000 DM” do të zëvendësohet me “500 euro”;
- (f) Fjalët “45 fening për një litër*” do të zëvendësohen me fjalët “27.5 centë për një litër”;
- (g) Fjalët “40 fening për një litër*” do të zëvendësohen me fjalët “25 centë për një litër” dhe
- (h) Hiqet fusnota e shtojcës A që shpjegon ylthin (*).

Neni 2
Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 3
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 janar 2002.

Hans Haekkerup,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm